



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 49/09

Prishtinë, më 6.05.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Müfera Şinik, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin: **Përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Drejtori i Administratës së AAK-së, Afrim Lajçi, Drejtor i ZRRUM-së, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 22.04.2009;**
- 3. Shqyrtimi i Propozim - Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/57, dt. 13.03.2009 lidhur me përkrahjen e projektit multietnik për komunën e Novobërdës
Të ftuar : Përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të Agjencionit Kundër Korrupsionit për vitin 2008
I ftuar : Z. Hasan Preteni, Drejtor i AKK-së;**
- 5. Shqyrtimi i pjesës financiare të Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2008
I ftuar : Z. Afrim Lajçi, Drejtor i ZRRUM-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
8. **Të ndryshme,**
 - 8.1. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);**
 - 8.2. **Miratimi i listës së organeve dhe agjencive të pavarura, të cilat bëjnë pjesë në kuadër të fushëveprimtarisë së Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision funksional.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 22.04.2009

Safete Hadërgjonaj, theksoi se në diskutimet e saja në pikën 3 dhe 4.1 të rendit të ditës nuk është kuptuar mirë. Disa fjali të përfshira në procesverbal nuk janë shkruar drejtë ashtu siq ka thënë ajo. Prandaj kërkoi që të korrigjohen diskutimet e saja në këto pika.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 1.04.2009, miratohet me vërejtjet e znj. Safete Hadërgjonaj.

3. Shqyrtimi i Propozim - Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/57, dt. 13.03.2009 lidhur me përkrahjen e projektit multi-etnik për komunën e Novobërdës

Kryesuesi, theksoi propozim – vendimi i Qeverisë në aspektin financiar nuk është i kompletuar. Nuk kemi sqarime se a është projekt i planifikuar me buxhetin e vitit 2009, apo është projekt i ri. Nëse kemi të bëjmë me transferim të mjeteve ndërmjet organizatave buxhetore, do të duhej të bashkëngjiteshin shkresat përcjellëse që tregojnë transferimin e mjeteve nga një kod buxhetor në tjetrin.

Kosara Nikolic, theksoi se kemi pasqyrim të ndryshme për numrin e familjeve, andaj kërkoi sqarim për numrin e saktë e tyre që do të përfitojnë nga ky projekt.

Zahir Bajrami, sqaroi se ky projekt është paraparë në kuadër të buxhetit 2009. Qëllimi i tij ka qenë që të krijohet një kod i posaçëm për këtë projekt, e që punët operative do të udhëhiqej nga Ministria e Shërbimeve Publike. Projektin do të realizohet nga mjetet buxhetore që do të ndajnë ministritë e caktuara dhe Zyra e Kryeministrit dhe një pjesë Qeveria Norvegjeze.

Hasan Isufaj, theksoi se në MEF-i kemi sugjeruar që të kompletohet ky vendim duke përdorur kodet buxhetore për këtë transfer nga organizatat buxhetore, dhe më pastaj të procedohet në Kuvend për miratim siç e parasheh ligji. Pas kësaj procedure do të krijohet një kod i veçantë për këtë projekt.

Besa Gaxherri, vlerësoi projektin të arsyeshëm, por theksoi se ai ka nevojë për plotësim. Përveç pjesës financiare që tregon transferin e mjeteve sipas kodeve buxhetore, projektin duhet korrigjuar edhe disa gabime tekstuale. Në tabelë shifet se janë shtuar edhe dy familje (nga 27 në 29), gjë që duhet dokumentuar. Pas këtyre plotësimeve ky projekt mund të përkrahët nga komisioni.

Xhevdet Neziraj u pajtua me kërkesat se raporti për nga aspekti financiar duhet plotësuar. Bëri vërejtje për identifikimin e komunitetit egjiptas, rom dhe ashkali si komuniteti RAE, gjë që shifet edhe në këtë projekt. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për komunitete dhe si rezultat i kësaj po ndodh një diskriminim i këtyre komuniteteve, në përfitimin e projekteve dhe në punësim. Përndryshe përkrahu projektin.

Srdan Sentić, u pajtua me disa gabime teknike që janë në raport, por kjo ka ndodhur me insistimin për të balancuar komunitetet në përfitimin nga ky projekt. Sa i përket kategorizimit të komunitetit në RAE, një gjë e tillë është bërë nga UNHCR dhe jo nga Zyra e Kryeministrit.

Kryesuesi, vlerësoi të arsyeshëm projektin, por theksoi se Komisioni nuk mund të jap rekomandimin, pa kompletimin e materialit që arsyeton bartjen e mjeteve sipas kodeve buxhetore për këtë projekt. Prandaj kërkoi që ky propozim-vendim të kompletohet për mbledhjen e radhës së komisionit.

Pasi që vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Të plotësohet Propozim – Vendimi te Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/57, dt. 13.03.2009 lidhur me përkrahjen e projektit multietnik për komunën e Novobërdës, me shkresat përcjellëse që arsyetojnë bartjen e mjeteve sipas kodeve buxhetore për këtë projekt.

4. Shqyrtimi i Raportit të Agjencionit Kundër Korrupsionit për vitin 2008

Kryesuesi, ia dha fjalën përfaqësuesit të AAK-së për prezantimin e raportit.

Bedri Bektashi, theksoi se në vitin 2008, mosrekrutimit i stafit te ri në mungesë të profesionalizmit ka ndikuar në shpenzimin e mjeteve për paga dhe meditje si dhe mallra dhe shërbime. Një problem tjetër që kemi pasur gjatë atij viti, ka qenë mosrealizimi i kërkesës së mjeteve për rrezikshmëri nga MEF-i, edhe pse një kërkesë e tillë është aprovuar nga Kuvendi.

Safete Hadërgjonaj, pyeti pse nuk po i'u lejohen mjetet për rrezikshmëri?

Kryesuesi, duke u ndërlidhur, theksoi se Ministria e Shërbimeve Publike duhet të zbatojë vendimet e Kuvendit, derisa sa të miratohet ligjit për pagat, i cili do ti rregulloj këto çështje.

Pasi që vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se me 9 vota Për, një Abstenim (znj. Safete Hadërgjonaj) dhe asnjë Kundër, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të miratojë Raportin e Agjencionit Kundër Korrupsionit për vitin 2008.

5. Shqyrtimi i pjesës financiare të Raportit se Zyrës se Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2008

Kryesuesi, ia dha fjalën përfaqësuesit të ZRRMU-së për prezantimin e raportit.

Afrim Lajqi, shpjegoi pjesën financiare të raportit. Theksoi buxheti i tyre ka qenë modest dhe e jemi në një pozitë më të disfavorshme në krahasim me rregullatorët tjerë në kategorinë paga dhe medijtje.

Kryesuesi, pyeti sa është numri i punëtorëve dhe si bëhet përcaktimi i lartësisë së taksës.

Safete Hadërgjonaj, duke u ndërlidhur në diskutimin për pozitën e disfavorshme të këtij rregullatori në krahasim me tjerët, theksoi se të gjithë rregullatorët nuk e kanë statusin e njëjtë, me ligj disa janë të rangut më të lartë e disa më të ultë. Theksoi se i ka bërë përshtypje kërkesa e kësaj zyre për rritje të pagave pas bartjes së kompetencave të rezervuara. Raporti si tillë do të duhej të ishte më i kompletuar dhe të përgatitej konform formularëve standard për raportim.

Myrvete Pantina, theksoi se raporti është i pasur me të dhëna. Megjithatë kërkoi një sqarim lidhur me atë se qfarë masa kanë ndërmarrin ndaj atyre kompanive që nuk paguajnë taksat?

Besa Gaxherri, vlerësoi të përgatitur mirë raportin. Megjithatë kërkoi sqarim se qfarë masash keni ndërmarr ndaj atyre kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave që nuk kanë paguar taksat. Theksoi se ndaj këtyre kompanive duhet ndjekur procedurat ligjore për shkak të moskryerjes së obligimeve. Në raportin tjetër do të analizohet se qfarë është ndërmarrë në këtë drejtim.

Afrim Lajqi, duke i përgjigjur pyetjeve, theksoi se zyra jonë i ka 19 punëtorë. Sa i përket caktimit të lartësisë së taksave ligji lejon kësaj zyre të bëjë përcaktimin e lartësisë së taksës dhe ajo nuk duhet tejkaloj 1.5 % të shumës së kompanisë respektive. Lartësia e taksës korrespondonë edhe me lartësinë e buxhetit tonë. Sa i përket masave ndaj kompanive që nuk përmbushin obligimet, ligji lejon të drejtën e revidimit të licencës, por ne kemi vlerësuar se kjo nuk është zgjidhje.

Kryesuesi, pagat e rregullatorëve përcaktohen varësisht nga tregu i fushës që mbulojnë, kjo është një praktikë ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket përmbushjes së obligimeve nga kompanitë publike, duhet insistuar më shumë për që ato ti kryejnë obligimet.

Pasi vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota Për, një Abstenim (znj. Safete Hadërgjonaj) dhe asnjë Kundër, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të miratojë Raportin financiar të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2008.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Safete Hadergjonaj, si anëtare e komisionit funksional theksoi se nuk është pajtuar me disa amendamente të propozuara, sepse me ato krijohet një monopol në tregtinë me naftë. Këshilli është zëvendësuar me Zyrën për Licenca që nuk dihet sa anëtarë do ti ketë.

Besa Gaxherri, theksoi se ky ligj po krijohet për të plotësuar interesat e atyre kanë monopolizuar tregun e naftës. Prandaj edhe nuk do të përkeqësojë amendamentet e propozuara.

Shkumbin Demaliaj, një situatë e tillë po krijohet edhe për shkak të mungesës së instituteve profesionale për këto çështje.

Pasi vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se me tetë vota Për, një Abstenim (znj. Safete Hadergjonaj) dhe një Kundër (znj. Besa Gaxherri), Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi se pas miratimit në parim të Projektligjit për TVSH, në bashkëpunim me NDI do të organizojmë një debat publik ku do të ftohen grupet e interesit interesuarit. Po ashtu njoftoi se në bashkëpunim me NDI do të fillohet të bëhet monitorimi i Ligjit për financat lokale.

Në të ndryshme kryetari njoftoi edhe për listën e agjencioneve të pavarura që bëjnë pjesë në kuadër të komisionit, e cila është kompletuar dhe është dërguar Kryesisë sipas kërkesës së tyre.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI